




Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRANUAR/DORËZUAR DATE PRESENTED/SUBMITTED:		26-01-2024	
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prog. No.	Nr. faqeve Br. Stranica No. Pages
10/6	112	52	12



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

PLANI PËR INTEGRITET

(2024 – 2026)

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

Prishtinë, janar 2024

Përmbajtja

DEKLARATA E INTEGRITETIT	3
HYRJA	4
1. PLANI I INTEGRITETIT.....	5
2. PARIMET E MENAXHIMIT TË INTEGRITETIT.....	6
2.1. Lidershipi	6
2.2. Përfshirja e personelit.....	6
2.3. Qasja sistemore.....	6
3. PROCESI I ZHVILLIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT.....	7
3.1. Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit.....	7
3.2. Metodologjia e vlerësimit të rrezikut.....	7
4. MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT DHE RAPORTIMI....	9
5. FUSHAT E RREZIKUT.....	10
6. TABELA E VLERËSIMIT TË RREZIKUT.....	11

DEKLARATA E INTEGRITETIT

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, ne jemi të obliguar të zbatojmë standarde të larta profesionale, etike dhe të japim shembullin për t'i shërbyer interesit publik, në mënyrë që të gjitha veprimet tona të jenë me integritet të lartë, me vlera etike dhe të bazuara në ligj. Duke identifikuar dhe adresuar rreziqet potenciale të konfliktit të interesave, pavarësisë dhe objektivitetit, ne vazhdimisht synojmë të përmirësojmë cilësinë e punës për të shmangur dhe parandaluar korrupsionin, si dhe fuqizimin e kapaciteteve institucionale ndaj shkeljeve të integritetit.

Zyra Kombëtare e Auditimit në funksion të përmbushjes së misionit kushtetues e ligjor ka hartuar planin e integritetit që do të ndihmojë në rritjen e nivelit të transparencës, ndershmërisë dhe përgjegjësisë në të gjitha sferat e veprimtarisë. Deklarata mbështetet në Ligjin Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Për institucionin tonë integriteti është vlerë, që nënkupton se personeli duhet t'i përmbahet standardeve të larta të sjelljes, ndershmërisë dhe sinqeritetit gjatë kryerjes së përgjegjësisë si dhe në marrëdhëniet me personelin e entiteteve të audituara.

Ky Plan Integriteti përfshin rreziqe në fushat e përgjegjësisë institucionale sipas fushave funksionale të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe aktivitetet konkrete për adresimin e tyre.

Zyra Kombëtare e Auditimit kujdeset për krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës të punës, që nxit dhe promovon kulturën e integritetit në nivel institucional dhe në nivel individual, nëpërmjet një sistemi funksional të menaxhimit të integritetit në ZKA. Ne kemi një angazhim të përhershëm ndaj vlerave etike dhe kemi përpiluar këtë deklaratë për të udhëhequr sjelljen tonë në mënyrë që të përmbushim standardet më të larta të integritetit dhe përgjegjësisë shoqërore. Vlen të theksohet se Zyra Kombëtare e Auditimit në vitin 2023 sipas vlerësimit për Sistemin e Integritetit Kombëtar të Kosovës, të realizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës/ Transparency International Kosova është renditur si institucioni me nivelin më të lartë të integritetit.

Prandaj, unë deklaroj përkushtimin maksimal që ta avancoj më tutje ruajtjen dhe avancimin e sistemit për menaxhimin e integritetit brenda Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Vlora SPANCA

Auditore e Përgjithshme

HYRJA

Në pajtim me nenin 25 Ligjit nr.08/1-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe në përputhje me “Metodologjinë e Planeve të Integritetit” të cilat obligojnë të gjitha institucionet të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit, **Zyra Kombëtare e Auditimit** ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2024 -2026.

Plani i integritetit është një dokument i brendshëm tre (3) vjeçar dhe përditësohet çdo vit. Është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cënueshmërisë së integritetit brenda Institucionit dhe që ofron masa për menaxhimin e integritetit për të arritur objektivat e integritetit të Institucionit.

Plani rritet përkushtimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet brenda fushëveprimit të institucionit.

Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të institucionit dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

1. PLANI I INTEGRITETIT

Plani i Integritetit është një dokument strategjik dhe operativ, i cili i shërben për parandalimin e rreziqeve që cenojnë integritetin e zyrtarëve në veçanti dhe institucionit në përgjithësi. Ky dokument ka rol të rëndësishëm në fuqizimin e rezistencës institucionale ndaj korrupsionit.

Plani përmban elementet e mëposhtme:

- një vetëvlerësim të ekspozimit të institucionit ndaj korrupsionit dhe formave të tjera të shkeljes së integritetit;
- informacion për fushëveprimin e institucionit dhe burimet njerëzore të angazhuara në institucion;
- llojet e rreziqeve të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit, masat ekzistuese të kontrollit;
- masat parandaluese për zvogëlimin e rrezikut të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit dhe afatet për zbatimin e tyre;
- informacion për personin përgjegjës për menaxhimin e hartimit dhe zbatimin të planit të integritetit;
- të dhëna të tjera, në përputhje me Metodologjinë për hartimin e planit të integritetit.

Përmes Planit të Integritetit synohet:

- Rritja e mundësive që institucioni të arrijë objektivat e menaxhimin e integriteti;
- Identifikimi i rreziqeve dhe masave për zvogëlimin e rreziqeve;
- Përmirësimin e kontrolleve ndaj rreziqeve të identifikuara;
- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale;
- Rritjen e besimit të stafit dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstron nga Institucioni.

2. PARIMET E MENAXHIMIT TË INTEGRITETIT

2.1.Lidershipi

Menaxhmenti i lartë i Zyrës Kombëtare të Auditimit ka treguar gatishmëri dhe përkushtim aktiv duke ofruar përkrahje maksimale Grupit Punues gjatë hartimit të Planit të Integritetit në të gjitha fazat e procesit.

2.2 Përfshirja e personelit

Në procesin e hartimit të Planit të Integritetit janë përfshirë të gjithë punonjësit e Zyrës Kombëtare të Auditimit. Punonjësit përmes përgjigjeve të tyre kanë komunikuar dhe reaguuar për mundësitë që mund të i ekspozohen rreziqeve të integritetit.

2.3.Qasja sistemore

Zyra Kombëtare e Auditimit i kushton vëmendje të gjitha komponentëve të sistemit dhe me përkushtim analizon marrëdhënien dhe ndërvarësinë ndërmjet tyre. Kjo realizohet përmes Grupit Punues, Personit Përgjegjës për Zbatimin e Planit të Integritetit dhe Menaxhmentit të Lartë të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

- Qëllimet e Planit të Integritetit
 - Sistem efektiv i menaxhimit të integritetit në institucion;
 - Llogaridhënie publike dhe transparencë;
 - Rezistencë institucionale ndaj cenimeve të integritetit;
 - Planifikim i menaxhimit të rrezikut ndaj integritetit në institucion.

3. PROCESI I ZHVILLIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

3.1.Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit përbëhet prej disa faza si në vijim:

- **Faza e parë:** Auditorja e Përgjithshme ka miratuar vendimin për emërimin Koordinatorit dhe Grupit Punues për hartimin e Planit të Integritetit. Ky grup pune përbëhet nga tre anëtarësh. Grupi punues ka shqyrtuar kornizën ligjore (rregulloret, planet, kontrollin e brendshëm të auditimit, sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, si dhe burime të tjera informacioni për fushat dhe proceset e punës). Ka mbajtur takimet e rregullta dhe takimet me menaxhmentin e lartë.
- **Faza e dytë:** Grupi punues ka shpërndarë pyetësonin online tek i gjithë stafi. Pyetësonit iu kanë përgjigjur 143 pjesëmarrës të të gjitha niveleve funksionale ne Zyrën Kombëtare të Auditimit. Pas pranimit të rezultateve të pyetësonit, Grupi Punues ka bërë përmbledhjen e përgjithshme të përgjigjeve. Po ashtu, janë realizuar disa intervista me qëllim të përpunimit të sondazhit të vetëvlerësimit. Mbi bazën e rezultatit të pyetësonit dhe intervistave është bërë identifikimi i rreziqeve. Për të gjitha takimet dhe për të gjitha fazat e procesit janë hartuar procesverbale të veçanta.
- **Faza e tretë:** Grupi punues duke analizuar të dhënat e siguruara ka përpiluar tabelat e rrezikut dhe ka adresuar cenueshmërinë e integritetit duke propozuar masat për përmirësim. Në fund, Zyra Kombëtare e Auditimit pas përfundimit të planit dhe aprovimit nga Auditorja e Përgjithshme publikon planin e integritetit dhe miraton masat për përmirësimin e integritetit për periudhën tre (3) vjeçare.

3.2. Metodologjia e vlerësimit të rrezikut

Metoda e Vlerësimit të rreziqeve përcakton probabilitetin e shfaqjes dhe pasojave të cenimit të integritetit dhe formave të tjera të sjelljes së paligjshme ose jo etike.

Përmes vlerësimit të rrezikut përcaktohet mundësia e ndodhjes dhe niveli i pasojës, i cili mund të jetë: i ulët/i mesëm/i lartë. Niveli përfundimtar i rrezikut përcaktohet sipas matricës së rrezikut, në formën e një kombinimi mes mundësisë dhe pasojës.

Figura 1 . Matrica e vlerësimit të rrezikut

Pasoja /Ndikimi	Madhor	10									
		9									
		8									
	Mesatar	7									
		6									
		5									
		4									
	Vogël										
Intenziteti i rrezikut (gjasat X ndikimi)		Ulët	Mesatar				Lartë				
		Probabiliteti/Gjasat									

Intenziteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në figurën si më lartë. Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të cenimit të integritetit, vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 - 15	16 - 48	49 - 100

- Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.
- Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.
- Rreziku me intensitet të lartë – korrupsioni ose format e tjera të cenimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

4. MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT DHE RAPORTIMI

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi nga Zyrtari përgjegjës i emëruar nga Auditorja e Përgjithshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në hartim ashtu edhe në zbatim, dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu, monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e rreziku kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioriteteve të rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësimë duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Gjithashtu, pas hartimit të raportit për zbatimin e planit të integritetit nga zyrtari përgjegjës në Zyrën Kombëtare të Auditimit, raporti duhet të dërgohet për vlerësim në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

5. FUSHAT E RREZIKUT

Fushat e përgjithshme të Rrezikut

- Fusha e menaxhimit financiar;
- Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Fusha e kontrollit, auditimit dhe të mekanizmave kundër korrupsionit;
- Komunikimi dhe informimi;
- Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumenteve etj.

FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT

Identifikimi i rrezikut		Intensiteti i rrezikut			Masat ndaj rrezikut		Afati i realizimit		
Nr.	Fusha rrezikut	Përshkrimi Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	
1.	Komunikimi dhe Informimi	Mungesa e rregullave të shkruara për mënyrën e komunikimit në nivelin e ZKA-mund të ndikojë në kryerjen e veprimeve jo të duhura.	Strategjia për komunikimin e ZKA-së	4	6	24	Në proces të hartimit të akteve të brendshme që rregullojnë procedurën e komunikimit të brendshëm.	Departamenti për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore Si dhe Departamenti për Çështje Juridike dhe kundër Mashtrimeve	Në vazhdimësi
2.	Integriteti	Mungesa e njohurive të mjaftueshme lidhur me parimet dhe vlerat etike mund të ndikojë në dëmtim të imazhit dhe përfaqësimit institucional.	Kodi i etikës dhe mirësjelljes (deklarata e kodit të etikës)	3	6	18	Trajnime me të shpeshta dhe specifike për gjithë stafin e ZKA-së. Rishikimi i Kodit të Etikës dhe Mirësjelljes, në baza vjetore.	Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	Në vazhdimësi

3.	Konflikti i interesit	Ekspozimi ndaj konfliktit të interesit gjatë procesit të kryerjes së detyrave dhe përgjegjësiave (subjektiviteti, interesi i caktuar personal, ushtrimi i ndikimit) ndikon në humbjen e pavarësisë dhe uljen e besueshmërisë së Kuvendit dhe qytetarëve ndaj ZKA-të së.	Aktet ligjore në fuqi dhe Kodi i etikes dhe mirësjelljes (deklarata e pavarësisë profesionale e cila nënshkruhet në fillim të çdo angazhimi auditues)	3	7	21	Informimi dhe vetëdijësimi rreth parandalimit të konfliktit të interesit	Departamenti për Metodologji në Auditim, Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore Dhe Departamentit për Çështje Juridike dhe kundër Mashtrimeve	Në vazhdimësi
----	-----------------------	---	---	---	---	----	--	---	---------------